



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E
PROJEKTEVE STRATEGJIKE,
EVROPËS, MIGRACIONIT, DIASPORËS,
KOMUNIKIMIT DHE TRANSPARENCËS

Nr. 742 Prot.

Lezhë, më 20/01/2026

RAPORT VJETOR PËR DËGJESAT PUBLIKE PËR VITIN 2025

Procesi i njoftimeve dhe konsultimeve publike është realizuar në zbatim të Ligjit Nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe konsultimin Publik”, Ligjit Nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Vendimin Nr.393 datë 18.07.2022 “Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Lezhë”. Bashkia Lezhë dhe Këshilli Bashkiak kanë bashkëpunuar për realizimin e një procesi konsultimi efikas dhe hartimin e një plani vjetor të përbashkët. Në zbatim të Vendimit të Kryetarit të Bashkisë me Nr.16, datë 17.01.2024 “Për miratimin e planit vjetor 2025, të konsultimeve publike në Bashkinë Lezhë” është miratuar plani i konsultimeve publike të cilat janë zhvilluar në koordinim me Këshillin e Bashkisë Lezhë. Hartimi i kalendarit është bërë në vijim të parashikimeve për konsultime të përcjellura nga drejtoritë e brendshme të Bashkisë, disa prej të cilave kanë mbetur vetëm në kuadrin e parashikimeve dhe nuk janë realizuar përgjatë vitit. Gjatë vitit 2025 janë parashikuar për tu realizuar 11 konsultime publike dhe janë realizuar 13 konsultime me banorë në qytetin e Lezhës dhe njësitë administrative përkatëse. Të gjitha dëgjesat/konsultimet publike janë pasqyruar në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Lezhë lezha.gov.al, në këndin “Transparenca”, seksioni “Konsultime publike” në linkun <https://lezha.gov.al/thirrje-per-konsultim-publik/> dhe tek “Programi i Transparencës”. Ky raport vjetor është hartuar në zbatim të detyrimeve që cakton Ligji Nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

➤ Numri i akteve të miratuara nga organi publik përkatës gjatë vitit 2025.

Këshilli Bashkiak Lezhë ka miratuar në total 124 vendime gjatë vitit 2025, të cilat gjenden të publikuara në faqen zyrtare të Bashkisë Lezhë, përkatësisht në këndin “Këshilli Bashkiak” në sesionin “Vendime të Këshillit Bashkiak” në linkun <https://lezha.gov.al/vendimet-e-keshillit-bashkiak-lezhe-2024/>.

➤ Numri i rekomandimeve të marra nga palët e interesuara

Për konsultimet e zhvilluara gjatë vitit 2025 numri i rekomandimeve/sygjerimeve/mendimeve të dhëna nga të pranishmit ka qenë 49.

➤ Numri i rekomandimeve e të komenteve të pranuar dhe të refuzuara

Në disa prej konsultimeve të zhvilluara të pranishmit kryesisht kanë diskutuar dhe shtruar pyetje/komente të cilat kanë qenë me tepër në kuadrin e sqarimeve dhe informimit sesa rekomandimeve konkrete. Për konsultimet e zhvilluara gjatë vitit 2025 numri i rekomandimeve e komenteve të pranuar është 22.



➤ Numri i takimeve publike të organizuara:

1. Datë 21.01.2025/ Dëgjese Publike në lidhje me heqjen nga Fondi Pyjor Kombëtar në Ekonominë Pyjore “Mali i Rrencit”.

Bashkia Lezhë ka publikuar më datë 30.12.2024 njoftimin për organizimin e dëgjesës publike në lidhje me heqjen nga fondi pyjor kombëtar në ekonominë pyjore “Mali i Rrencit”. Kjo dëgjese publike u inicua nga Drejtoria e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve. Bazuar në projekt-vendim është propozuar të shprehet dakordësia për vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor kombëtar të sipërfaqes pyjore në pronësi private, për ndërtim objekti me funksion kompleks turistik, resort me suite dhe 5 kate mbi tokë dhe 1 nën tokë nga shoqëria “Princë Adriatik Resort” dhe shoqëria “Prince Junior”. Njoftimi është i publikuar në linkun: <https://lezha.gov.al/njoftim-per-organizimin-e-degjeses-publike-ne-lidhje-me-heqjen-nga-fondi-pyjor-kombetar-ne-ekonomine-pyjore-mali-i-rrencit/> së bashku me dokumentat e tjera shoqërues (projekt-vendim, relacion, raport mbi studimin tekniko-ekonomik, procesverbali). Sipas listëprezencës në takim morën pjesë 44 persona.

2. Datë 20.05.2025/ Dëgjese publike për miratimin e hapjes së rrugës së varrezave të fshatit Rras, Njësia Administrative Ungrej, në fondin pyjor bashkiak dhe procedurën për përdorimin e sipërfaqeve që do të preken nga ndërtimi i rrugës auto të varrezave të fshatit Rras, Njësia Administrative Ungrej.

Bashkia Lezhë ka publikuar më datë 30.04.2025 (data e njoftimit zyrtar në faqen e WEB-it) njoftimin për organizimin e dëgjesës publike në lidhje me miratimin e hapjes së rrugës së varrezave të fshatit Rras, Njësia Administrative Ungrej, në fondin pyjor bashkiak dhe procedurën për përdorimin e sipërfaqeve që do të preken nga ndërtimi i rrugës auto të varrezave të fshatit Rras, Njësia Administrative Ungrej. Kjo dëgjese publike u inicua nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban. Nëpërmjet këtij konsultimi propozohet miratimi i hapjes së rrugës auto të varrezave me një gjatësi prej 1.03 km në sipërfaqen pyjore prej 0.42 ha pyll në pronësi të Bashkisë Lezhë, sipas raportit tekniko ekonomik të hartuar. Njoftimi është i publikuar në linkun: <https://lezha.gov.al/njoftim-per-organizimin-e-degjeses-publike-per-miratimin-e-hapjes-se-rruges-se-varrezave-te-fshatit-rras-njesia-administrative-ungrej/> së bashku me dokumentat e tjera shoqërues (projekt-vendim, relacion, raport mbi studimin tekniko-ekonomik, procesverbali).

❖ Mars 2025/ Konsultim publik për Planin Vendor të Veprimit për Migracionin dhe Diasporen 2025-2030 parashikuar në mars 2025 do të zhvillohet gjatë vitit 2026.

3. Datë 20.05.2025/ Dëgjese publike për miratimin e hapjes së rrugës publike në fshatin Ungrej, Njësia Administrative Ungrej.

Njoftimi për zhvillimin e takimit konsultues është publikuar në linkun <https://lezha.gov.al/njoftim-per-organizimin-e-degjeses-publike-per-miratimin-e-hapjes-se-rruges-publike-ne-fshatin-ungrej-njesia-administrative-ungrej/>. Konsultimi u zhvillua me datë 20.05.2025 në sallën e Bibliotekës “Gjergj Fishta” Lezhë. Hapja e kësaj rruge publike e cila do të ketë një gjatësi prej 900 m do të jetë në pronësi publike, ka si qëllim mundësimin e levizjes



së lirë të banorëve të zonës, kalimin e mjeteve të emërgjencës etj. Nga të pranishmit nuk kishte asnjë kundërshtim për miratimin e këtij propozimi.

4. Datë 24.06.2025/ Konsultim Publik për PBA-në 2026-2028, buxhetin vjetor si dhe Paketën Fiskale 2026 (Faza e parë).

Kjo dëgjesë publike u zhvillua në bashkëpunim mes administratës së Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak Lezhë, me pjesëmarrjen e banorëve nga gjitha njesitë administrative. Takimi u hap nga Kryetari i Bashkisë i cili bëri një paraqitje të punëve të realizuara si dhe atyre që do të bëhen kryesisht në lidhje me projektet e investimeve që do të zbatohen, shërbimet që do të kryhen dhe nivelin e taksave dhe tarifave që do të aplikohen. Problematikat e ngritura nga pjesëmarrësit ishin kryesisht në lidhje me:

- Infrastrukturen e lagjes së vjetër në qytetin e Shëngjinit, rehabilitimin e lulishteve;
- Ndërhyrje në riparimin e urës së Matit;
- Rehabilitimi i ndriçimit dhe asfaltimi i rrugëve në fshatin Balldre, etj.

Sipas listëprezencës në takim kanë marrë pjesë 58 persona.

Njoftimi dhe dokumentacioni shoqëruar për dëgjesën publike janë publikuar në web në linkun <https://lezha.gov.al/njoftim-per-organizimin-e-degjeses-publike-per-pba-ne-2026-2028-buxhetit-vjetor-dhe-paketen-fiskale/>

5. Datë 22.06.2025/ Dëgjesë Publike për miratimin e hapjes së rrugës publike Butëm në fshatin Ungrej, Njesia Administrative Ungrej.

Ky konsultim publik kishte në fokus procedurën e dhënies në përdorim të fondit pyjor kombëtar shoqërisë “T&J Construction Sh.p.k” për ndërtimin e rrugës auto të lagjes Butëm, fshati Ungrej, Njesia Administrative Ungrej. Ky projekt do të ndërtohet për nevojat e komunitetit dhe financohet nga Këshilli i Qarkut Lezhë, për të cilët kërkohet miratimi i hapjes së rrugës me VKB. Rruga auto do të ketë gjatësi 0.565 km dhe do të ndërtohet në sipërfaqen pyjore 0.23 ha pyll në pronësi të Bashkisë, sipas raportit tekniko ekonomik. Ky takim u zhvillua me datë 22 Qershor në sallën e bibliotekës “Gjergj Fishta” Lezhë në të cilin ishin të pranishëm grupet e intersit, banorë të zonës, etj. Sipas listëprezencës në takim moren pjesë 21 persona. Në linkun <https://lezha.gov.al/njoftim-per-organizimin-e-degjeses-publike-per-miratimin-e-hapjes-se-rruges-publike-ne-fshatin-ungrej-njesia-administrative-ungrej/> gjeni dokumentacionin për këtë dëgjesë publike.

6. Datë 20.08.2025/ Dëgjesë publike në lidhje me miratimin e Planit Vendor të Veprimit për Barazi Gjinore 2025-2030.

Plani Vendor i Veprimit për Barazi Gjinore 2025-2030 është ndërtuar mbi 5 fusha kryesore të ndërhyrjes:

- Promovimi i të drejtave ekonomike, sociale, punësimi dhe fuqizimi i vajzave/grave,
- Rritja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grave në vendimmarrjen politike,
- Liri nga format e dhunës ndaj vajzave/grave dhe dhunës në familje,
- Integrimi gjinor në politikën vendore,
- Fuqizimi i grave në zhvillimin e qendrueshëm, menaxhimin e burimeve natyrore.



Në këtë dëgjese publike moren pjesë 38 pjesëmarrës, nga të cilët banorë, përfaqësues nga institucionet (Zyra Rajonale e Punësimit), Këshilli Bashkiak etj. Diskutimet nga pjesëmarrësit ishin kryesisht në lidhje me barazinë gjinore në punë, pjesëmarrjen e barabartë të burrave dhe grave për vendet e punës, ndërtimi i tregjeve lokale për më shumë mundësi punësimi dhe fuqizimi, përjashtimi nga detyrimet vendore për të gjitha vajzat dhe gratë në nevojë, etj.

7. Datë 20.08.2025/ Dëgjese publike në lidhje me miratimin e Planit Vendor Social 2026-2028

Ky konsultim publik u iniciua nga Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social dhe u zhvillua me datë 20.08.2025. Prioritetet e këtij plani synojnë ngritjen dhe funksionimin e Qendrës Multifunktionale në Njesinë Administrative Shënkoll, shërbimit të kujdesit për fëmijë pa kujdes prindëror, ngritja e një qendre ditore për të moshuarit si dhe shërbimi i këshillimit me telefon online. Përmes këtij plani synohet fuqizimi i sistemit komunitar të mbrojtjes dhe kujdesit social, përmirësimi i aksesit, cilësisë dhe gjithëpërfshirja e shërbimeve. Komentet e dala nga takimi i referohen përmirësimit të aksesit dhe ndërtimit të një godinë të re e të përshtatshme për Qendrën e Zhvillimit Ditor, rikonstruksioni i rampave në qytet, infrastrukturë dhe burime të mjaftueshme për stafet e shërbimeve sociale që japin shërbim. Në takim ishin ftuar të merrnin pjesë përfaqësues nga institucionet dhe nga grupet e interesit në komunitet (Shoqata e të Verbërve), përkatësisht 45 të pranishëm nga të cilët 38 ishin femra. Në faqen zyrtare gjenden të publikuara njoftimi për zhvillimin e konsultimit, relacioni, projekt-vendimi, plani dhe procesverbali i takimit.

8. Datë 20.08.2025/ Dëgjese publike në lidhje me miratimin e Planit Lokal të Veprimit për barazi, përfshirje dhe pjesëmarrjen e romëve dhe egjiptianëve në Bashkinë Lezhë për periudhën 2025-2030.

Njoftimi për zhvillimin e kësaj dëgjese publike është bërë në web me datë 21.07.2025, së bashku me të cilin janë publikuar edhe dokumentat e tjerë shoqërues. Ky plan është hartuar në bashkëpunim me organizatën “Drejtësi Sociale” dhe shërben si udhërrëfyes për disa fusha kryesore si arsimit dhe trashigimia kulturore, punësimi, mbrojtja sociale, strehimi dhe infrastruktura, shëndetësia dhe mundësitë e barabarta. Diskutimet nga të pranishmit lidheshin kryesisht me mos rakordimin e shifrave për numrin e popullsisë, nevojën për regjistrimin e tyre në zyrat e gjendjes civile, masat e ndërmarra kundër fenomenit të braktisjes së shkollës të tilla si bursa si nxitje për ndjekjen e arsimit të mesëm dhe kurset passhkollore.

9. Datë 20.08.2025/ Dëgjese publike në lidhje me miratimin e Planit të Arsimit Parauniversitar 2026-2028.

Qëllimi i këtij plani është hartimi i një platforme strategjike dhe gjithëpërfshirëse për një zhvillim të qëndrueshëm dhe cilësor për të gjitha strukturat e arsimit parauniversitar. Nëpërmjet tij synohet përmirësimi i shërbimit në të gjitha institucionet arsimore, përmirësimi i procesit të identifikimit dhe shërbimit të nxënësve, rritja e kapaciteteve të stafit si dhe angazhimi i komunitetit në jetën shkollore. Të pranishëm në këtë takim ishin 26 persona, nga të cilët 16 femra, përfaqësues nga OJF-të lokale, drejtues institucionesh arsimore, nxënës, prindër etj. Diskutimet dhe rekomandimet e dhëna konsistonin kryesisht tek transparenca në mbledhjen



dhe buxhetimin e kontributit vullnetar, blerja e mjeteve didaktike dhe kancelarike, mungesa e treguesve të matshëm në plan, marrja e masave për shmangjen e mbylljes së shkollave në fshatra, ndalimi i postimeve politike në faqet zyrtare të institucioneve arsimore. Gjatë këtij konsultimi janë dhënë 7 rekomandime nga të pranishmit.

10. Datë 24.09.2025/ Dëgjese publike në lidhje me miratimin e rregullores për kriteret dhe kushtet që agjencitë/shtëpitë funerale duhet të plotësojnë për ushtrimin e veprimtarisë së tyre

Kjo dëgjese u zhvillua me datë 24.09.2025 në ambientet e bibliotekës “Gjergj Fishta” dhe u organizua nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit. Në takim moren pjesë grupet e interesit, përfaqësues apo administratorë të agjencive dhe shtëpive funerale si dhe përfaqësues nga Këshilli Bashkiak. Në prezantimin e draft rregullores u theksuan disa pika që lidhen me dokumentacionin për pajisjen me licensë, kushtet që duhen plotësuar, shqyrtimi, pezullimi dhe heqja e licensës si dhe strukturat zbatuese. Sygjerimet e të pranishmëve kishin të bënin me distancën që duhet të ekzistojë mes agjensive, distanca nga zonat e banuara “zona e kuqe”, etj. Disa nga rekomandimet janë reflektuar në versionin përfundimtar të rregullores, konkretisht: zgjerimi i zonës së kuqe, reduktimi i numrit minimal të punonjësve të kërkuar. Sipas listëprezencës në takim moren pjesë 33 persona.

11. Datë 21.10.2025/Dëgjese publike për miratimin e hapjes së rrugës “Bypass i Shëngjinit”, Njësia Administrative Shëngjin, Bashkia Lezhë, dhe përdorimin fondin pyjor bashkiak.

Lidhur me miratimin e hapjes së rrugës “Bypass i Shëngjinit”, sipas relacionit shoqërues nuk bëhet heqje nga fondi pyjor dhe propozohet miratimi i hapjes së rrugës auto në Njesinë Administrative Shëngjin me gjatësi 8.49 km që kalon në parcelat pyjore të ekonomisë pyjore “Mali i Rrencit” dhe do të ndërtohet në sipërfaqen pyjore prej 7.64 ha sipas raportit teknik-ekonomik. Kjo dëgjese u organizua nga Drejtoria e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve. Gjatë prezantimit të projektit u diskutua mbi studimin tekniko-ekonomik për sipërfaqet pyjore që do të preken nga ndërtimi i rrugës auto si dhe rëndësinë që ka ky projekt dhe financimin e tij. Shqetësimet e të pranishmëve i referoheshin mundësisë për prishje objektsh, alternativat për nyje lidhëse me zonat e banuara që ta mund të aksesohen nga banorët e zonës, shpronësimi i banorëve, etj. Dokumentacioni për dëgjesen publike gjendet i publikuar në linkun <https://lezha.gov.al/per-organizimin-e-degjeses-publike-per-miratimin-e-projekt-vendimin-e-keshillit-bashkiak-per-miratimin-e-hapjes-se-rruges-bypass-i-shengjinit-njesia-administrative-shengjin-bashkia/>. Në takim moren pjesë 46 persona, nga të cilët 16 femra.

12. Datë 22.10.2025/Dëgjese publike për dhënien e dakortësisë për vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor kombëtar të sipërfaqes pyjore në pronësi të Bashkisë, për kryerjen e aktivitetit minerar në objektin Gjobardhaj, nga shoqëria “Gjoni” SHPK.

Qëllimi i kësaj dëgjese është marrja e dakordësisë për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor kombëtar të sipërfaqes prej 6.775 ha pyll në pronësi të Bashkisë Lezhë. Raporti tekniko-ekonomik për sipërfaqet pyjore që preken nga zhvillimi i aktivitetit minerar është hartuar nga Drejtoria e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve. Sipas dokumentacionit



të paraqitur edhe nga shoqëria përkatëse dhe të përcjellura nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, objekti i parashikuar për nxjerrje minerali bën pjesë në ngastrat pyjore të Ekonomisë Pyjore “Brinjat e Kreshtës”. Në këtë takim nuk pati diskutime apo vërenjtje kundër zhvillimit të zonës dhe procedurës së heqjes nga fondi pyjor kombëtar. Numri i personave që moren pjesë në takim ishte 28, nga të cilët 16 femra.

13. Datë 10/11/12/13 Nëntor 2025/ Konsultimet publike për PBA-në 2026-2028, buxhetin vjetor si dhe Paketën Fiskale 2026.

10 Nëntor 2025 – Bashkia Lezhë në koordinim me Këshillin Bashkiak Lezhë zhvilluan dëgjuesën publike në kuadër të hartimit të buxhetit 2026, PBA 2026-2028 dhe Paketës Fiskale me banorë të njësive administrative Balldre, Dajç, Blinisht, Kallmet dhe Ungrej, pranë ambientit të Zadrime Park në autostradë, me prezencën e panelit prej dhjetë anëtarësh; Kryetari i Bashkisë Z.Pjerin Ndreu, Zv.Kryetari Fatjon Zefi, Zv.Kryetarja Znj.Brikena Vuksani, Zv.Kryetarja Znj.Eueda Molla, Kryetari i Këshillit Bashkiak Z.Ndue Luli si dhe administratorët e njësive administrative. Çështjet kryesore që qytetarët paraqitën në këtë konsultim ishin për cilësinë dhe çmimin e ujit të pijshëm, ndërtimi i rrugës së varrezave të fshatit Blinisht, infrastruktura e fshatit Rrëze Mali në Balldre, rikualifikimi i qendrës së fshatit Blinisht, rikualifikimi i sistemit të ndriçimit të qendrës fshatit Gjadër, problematika me ujin vaditës në Piraj, probleme me pronat në Gjadër, etj. Rekomandimet e dhëna nga qytetarët ishin 10. Numri i pjesëmarrësve gjithsej ishte 80 nga të cilët 10 femra.

11 Nëntor 2025 – U zhvillua dëgjesa publike në kuadër të hartimit të buxhetit 2026, PBA 2026-2028 dhe Paketës Fiskale me banorë të njësive administrative Shënkoll, Zejmen dhe Kolsh, pranë ambienteve të Restorant “Orkidea Palace” në autostradë, me prezencën e panelit prej tetë anëtarësh. Mendimet dhe propozimet e dhëna ishin kryesisht për përmirësimin e sinjalistikës nga Barbulloja në Rrilë, sistemi i rrugës Lleshaj, përmirësimi i cilësisë së zbatimit të investimeve, problem me transportin në fshatra. Rekomandimet e dhëna nga qytetarët ishin 5. Numri i pjesëmarrësve gjithsej ishte 111 nga të cilët 26 femra.

12 Nëntor 2025 – Bashkia Lezhë zhvilloi konsultimin publik në kuadër të hartimit të buxhetit PBA-së dhe Paketës Fiskale me banorë të njësive administrative Shëngjin dhe Lezhë. Takimi u mbajt pranë ambienteve të Pallatit të Kulturës “Dedë Ndue Lazri” Lezhë me prezencën e Kryetarit të Bashkisë z.Pjerin Ndreu, zv.Kryetares znj.Brikena Vuksani, zv.Kryetares znj.Eueda Molla, zv.Kryetarit z.Fatjon Zefi, Kryetarit të Këshillit Bashkiak z.Ndue Luli, dhe Administratori i njësisë administrative Shëngjin z.Brahim Demi. Disa nga tematikat e trajtuara kanë të bëjnë me sigurinë e levizjes në rrugë për të verbërit, ndarja e investimeve sipas qasjes social-ekonomike, studim mbi zgjerimin e zonës urbane, shmangia e erozionit në zonat bregdetare, ndërtimi i bibliotekave në çdo qendër administrative, etj. Në takim morën pjesë banorë nga komuniteti, përfaqësues nga OJF, media lokale, grupe vulnerabël etj., afërsisht 238 persona nga të cilët 97 femra.

13 Nëntor 2025 –U zhvillua takimi me bizneset lokale në të cilën moren pjesë 149 persona, nga të cilët 11 femra. Takimi u drejtua nga Kryetari i cili shpjegoi qëllimin e dëgjuesës, prezantoi



PBA-2026-2028, buxhetin dhe paketen fiskale për vitin 2026 e në veçanti projektet e investimeve që do të zbatohen, shërbimet që do kryhen dhe nivelin e taksave dhe tarifave që do të aplikohen. Mendimet dhe propozimet e dhëna i referoheshin kryesisht hapësirave publike në plazhe, sistemimi i KUZ që derdhen në det, zgjerimi i hapësirave për parkim publik.

Procesverbalet e takimeve i gjeni në linkun <https://lezha.gov.al/njoftim-per-konsultimet-publike-per-pba-ne-2026-2025-dhe-buxhetin-vjetor-si-dhe-paketen-fiskale-te-bashkise-lezhe/>

❖ Dëgjesë publike për dhënien në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor kombëtar shoqërisë ONE ALBANIA SHA, për antenat e telefonisë celulare, fshati Balldre Njesia Administrative Balldre dhe fshati Mabë Njesia Administrative Dajç.

Kjo dëgjesë e iniciuar nga Drejtoria e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve parashikuar për tu zhvilluar me datë 18.12.2025 u anulua për shkak të pjesëmarrjes së ulët dhe është shtyrë për një moment të dytë.

KRYETARI
Pjerin NDREU

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Reinis ÇELA



Koordinatori për njoftimin dhe koonsultimin publik

Gjystina Nik-ulaj

Drejtori - Drejtoria e Projekteve Strategjike, Evropës Migracionit, Diasporës,
Komunikimit dhe Transparencës

Vasilika Laska